

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E SHËRBIMIT PYJOR TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Shërbimit PyJOR Tiranë, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare dhe vlerësues”, për aktivitetin 01.01.2012 deri më 31.12.2013, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 56, datë 16.06.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 59/15, datë 16.06.2014, dërguar Ministrit të Mjedisit dhe me nr. 59/14, datë 16.06.2014, dërguar z. Redion Çadri, drejtor i Drejtorisë së Shërbimit PyJOR Tiranë dhe nr. 59/17, datë 16.06.2014 drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Ministria e Mjedisit të marrë iniciativën për hartim të ndryshimit në kreun IV të Kodit Penal dhe ti përcjellë këto ndryshime në Këshillin e Ministrave për ushtrimin e nismës ligjvënëse, pasi një nga agresionet më të mëdha mjedisore që po vuan vendi ynë është edhe prerja e pakontrolluar e pyjeve. Fakti i thjeshtë i prerjes në mënyrë të paligjshme (pa autorizim ose në kohën e vendin e ndaluar) do të përbëjë një vepër penale kur nuk përbën një shkelje administrative. Nga pikëpamja jonë do të konsiderohen si vepra penale edhe ato drejtime që për shtrirjen e tyre të dëmshmërisë së shkaktuar supozojnë një çrregullim serioz të ekuilibrit të ekosistemit.

Propozimi për ndryshim

Kreu IV

1. Për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal.

Veprimet e mëposhtme përbëjnë vepra penale, kur kryhen në mënyrë të paligjshme dhe me qëllim, ose të paktën me neglizhencë të theksuar:

Neni 204 - Peshkimi i ndaluar

Peshkimi në kohë, me mjete, vende dhe mënyra të ndaluara përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Peshkimi i kryer me mjete të rrezikut të përbashkët si eksploziv, lëndë helmuese etj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Propozohet:

Neni 204 - Peshkimi dhe gjuetia e ndaluar

Peshkimi në kohë, me mjete, vende dhe mënyra të ndaluara **si dhe gjuetia** përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer **në dy vjet.**

Peshkimi i kryer me mjete të rrezikut të përbashkët si eksploziv, lëndë helmuese etj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Argumentimi

Në këtë nen mbrohen speciet e detit dhe sanksionohet peshkimi i tyre, kur realizohet në njërin nga mënyrat e mëposhtme:

- kur peshkohet në kohë dhe vende të ndaluara;
- kur peshkohet me mjete të ndaluara;
- kur peshkohet me mjete të rrezikut të përbashkët.

Pjesa e parë e drejtimit synon të ruaje speciet e detit në kohë dhe në vende me cenueshmëri ose me rrezikshmëri më të madhe për mbijetesën e tyre ashtu si dhe të reduktojë kapjen e tyre gjatë një periudhe kohe që konsiderohet e nevojshme për ruajtjen e tyre. Si përmbledhje, ajo që pretendohet është të kontrollohet mbijetesa dhe mbiekzistenca e specieve të detit duke evituar peshkimin e tyre të pa kontrolluar dhe abuziv.

Pjesa e dytë e drejtimit synon në të njëjtën kohë mbrojtjen e llojeve kur ndalohet peshkimi me metoda që janë të ndaluara. Që logjikisht janë ato të cilat për mungesën e selektimit ose për agresivitetin e tyre venë në një rrezik të madh jo vetëm mbijetesën e një lloji por të shumë llojeve.

Pjesa e tretë e drejtimit është një agravim i përdorimit të metodave të ndaluara. Në këtë rast sanksionohet më rëndë peshkimi duke përdorur disa metoda veçanërisht të rënda jo vetëm për llojet e peshqve por gjithashtu për vetë ekosistemin. Arsyeja e rëndësisë është karakteri katastrofik që mund të kenë këto teknika ilegale të peshkimit.

Me ligjin në fuqi kemi një surprizë, por kjo nuk është e lidhur me veprën penale të peshkimit të paligjshëm, **por ligjvënësi nuk ka vendosur normën paralele në të cilën duhet të ndëshkohet vepra penale e gjuetisë së paligjshme.**

Neni 205 - Prerja e paligjshme e pyjeve

Prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vende të ndaluara, kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Propozohet:

Neni 205 - Prerja e paligjshme e pyjeve

Prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vende të ndaluara, **ose të jenë dëmtuar Parqet Natyrore ose zonat e ngjashme me to ose mund të vërë në rrezik ekosistemin**, kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga **dy vjet deri në pesë vjet.**

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren të gjitha masat organizative për realizimin e detyrave të pa realizuar plotësisht nga auditë i mëparshëm dhe konkretisht:

- a. Të ndiqen procedimet administrative në gjykatë dhe në zyrën e përmbarimit deri në vjeljen e plotë dhe të mos mjaftohen vetëm me njoftimet.
- b. Të merren masa për disiplinimin dhe vënien para përgjegjësisë të individëve etj që shfrytëzojnë pa kriter nënproduktet e pyllit, pa lidhur kontrata me DSHP në zbatim të nenit 3, të ligjit nr. 7792, datë 15.6.1993 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”
- c. Në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, Gardën e Republikës dhe Drejtoritë e Taksave Vendore, të merren masa për të disiplinuar me fletë-hyrje të përditësuar mjetet e Policisë dhe të Gardës së Republikës, si dhe aplikimin e abonimeve mujore ose vjetore për mjetet e lokaleve që ushtrojnë aktivitet në parkun Kombëtar Mali i Dajtit, duke eliminuar regjistrin pa pagesë, i cili bëhet shkak për abuzim.
- ç. Të merren masa për hartimin e rregullores së brendshme të re, për organizimin dhe ndarjen e detyrave të seksioneve, të specialistëve në seksione dhe sektorëve e zonave pyjore si dhe paraqitjen për miratim në Ministrinë e Mjedisit.

2. Të merren të gjitha masat organizative për realizimin e detyrave të pa realizuara nga auditë i mëparshëm dhe konkretisht:

- a. Të merren masa për të bërë regjistrimin e Fondit Pyjor në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në pronësi të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Tiranë.
- b. Të merren masa për të hapur faqen e internetit të DSHP Tiranë, ku të publikohet regjistri i lejeve të gjuetisë.
- c. Të merren masa për të llogaritur dhe publikuar kapacitetin e prodhimeve të dyta pyjore, si dhe shfrytëzimi të realizohet nga subjekte private të specializuara dhe përzgjedhja e subjekteve të bëhet nëpërmjet tenderëve, të organizuar nga Organet e Shërbimit Pyjor.

ç. Të merren masa për të arkëtuar fitimin e munguar prej **2,036,594 lekë, nga** subjektet: ISP në vlerë prej 216,634 lekë, Iliria në vlerë prej 1,630,980 lekë dhe ROGAT në vlerë prej 188,980 lekë, në zbatim të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin pyjor dhe kullosor”.

d. Seksioni i Financë-Marketingut të përfshijë në projektbuxhet kërkesat për fonde për investime në Fondin Pyjor Shtetëror për planet e mbarështimit dhe për shpenzime gjyqësore për dërgimin e padive në Gjykatë dhe Përmbarim për vlerën e dëmeve në kundërvajtjet administrative duke bashkërenduar punën me Seksionet përkatëse në periudhën e hartimit të projektbuxhetit.

dh. Të analizohet dhe të detajohet vlera prej 72,634,382 lekë që rezulton në aktiv në llogarinë debitorë të ndryshëm dhe në pasiv detyrime e cila është e pa zberthyer.

e. Të hartojë planin për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar, planin strategjik, të përcaktojë objektivat, si dhe të hartojë plan-veprimet afatshkurtra për implementimin e Ligjit nr. 10.296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”.

ë. Në kuadrin e zbatueshmërisë të ligjit nr. 10.296, datë 08.7.2010, të bëhen kualifikime e seminare për zberthimin e ligjit, mënyrën e analizës së Menaxhimit të riskut, për tu njohur më mirë me konceptet e ligjit si dhe komponentët e MFK, për të gjithë menaxheret e shoqërisë më qëllim absorbimin dhe zbatimin sa më të mirë të tyre në praktikë.

f. Të bëhen ndryshime në rregulloren e brendshme, ku të implementohen sistemet e kontrollit të brendshëm.

3. Nga DSHP të merren masa që procedurat e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla të bëhen në mënyrë elektronike në përputhje me kërkesat e VKM nr. 47 datë 23.01.2013 “Për një shtesë në VKM nr. 45 datë 21.01.2009 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike” të ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” i ndryshuar me Udhëzimin e APP nr. 5 datë 16.07.2013 dhe Udhëzimin nr. 1 datë 28.02.2014 dhe të sigurohen gjurmët e auditit për gjithë procedurën në zbatim të Urdhrit të MF nr. 33 datë 11.07.2013 “Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

Vazhdimisht

4. Nga DSHP të merren masa që për shpenzimin e karburantit të plotësohet në mënyrë të plotë dokumentacioni autorizues, vërtetues e justifikues i lëvizjes së këtij lloj aktivi në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik” pika 10, 35, 36, 38.

Vazhdimisht

5. Nga Seksioni i Financës të merren masa për organizimin dhe mbajtjen e sistemit të kontabilitetit për kontabilizimin e plotë të saktë dhe në kohë të gjitha transaksioneve nëpërmjet regjistrimeve të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit si dhe hartimi i pasqyrave financiare për vitin 2013 në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”.

Menjëherë

6. Nga Seksioni i Financës të merren masa për analizën e gjendjeve të llogarive të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara të pasqyruara në bilanc dhe të konkretizohen me inventarin e tyre fizik dhe duke bërë njëkohësisht regjistrimin e tyre në librin historik të aktiveve.

Deri me 30 shtator 2014

7. Nga DSHP-ja të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës së qirasë ndaj subjekteve të cilat nuk kanë shlyer detyrimet për vitin 2012 në shumën prej **910,265 lekë** dhe **1,742,583 lekë** për vitin 2013, në mënyrë analitike për çdo subjekt sipas pasqyrës nr. 13, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

8. Nga DSHP-ja të ndiqen rrugët ligjore, arkëtimin e detyrimeve të palikuiduara për vitin 2012, për shumën **658,800 lekë**, për vitin 2013 për shumën **658,800 lekë** dhe konkretisht: Subjekti [REDAKTUAR] për 532,000 lekë, subjekti "[REDAKTUAR]" për 385,600 lekë dhe subjekti [REDAKTUAR] sh.p.k. për 500,000 lekë, *(Trajtuar në mënyrë të hollësishme sipas pasqyrës nr. 13, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Menjëherë

9. Nga DSHP-ja të kryhen çdo vit aktrakordimet me Ministrinë e Mjedisit dhe Pyjeve, për pagimin e vlerës së qirave nga subjektet private, në zbatim të kontratave të lidhura dhe të ndiqen në vazhdimësi pagesat e qirave për të shmangur efektet e zbatimit të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar neni 115, i cili përcakton se kontratat e pashlyera brenda 3 vjetësh parashkruhen.

Vazhdimisht

10. Nga DSHP-ja të hartohet database elektronik, në të cilin të regjistrohen të gjithë hapat ligjore dhe me afatet përkatëse me personat përgjegjës, si dhe të ndiqen rregullisht në gjykatë dhe me Zyrën e Përmbartimit deri në vjeljen e plotë të dëmeve dhe gjobave. Të analizohet çdo muaj në drejtori ecuria e proceseve gjyqësore dhe arkëtimeve të dëmeve dhe gjobave.

Vazhdimisht

11. Nga juristi i DSHP-së me marrjen e vendimeve gjyqësore për kundërvajtjet dhe dëmet administrative nëpërmjet protokollit ti kalojë Seksionit të Financës për kontabilizim. Nga DSHP të analizohet çdo 3-mujor zbatimi i aplikimit dhe vjella e gjobave dhe bazuar në ligjin nr. 8510, datë 15.07.1999 "Për përgjegjësitë jashtëkontraktore" dhe ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", të ngarkojë me ndëshkim administrativ me gjobë punonjësit që tolerojnë në mosvjeljen në vend të gjobës.

Vazhdimisht

12. Nga DSHP-ja të merren të gjitha masat për të organizuar veprimtarinë ekonomike financiare në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël" si dhe urdhrin e MF nr. 4292, datë 15.06.2006 "Për shpalljen e standardeve kontabël kombëtare dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", në mënyrë që për veprimtarinë e aktivitetit të drejtorisë të jepet një pamje e qartë e qëllimit të raportimit financiar, të besueshëm dhe real.

Vazhdimisht

13. Nga DSHP Tiranë të hartohen plane veprimi me Inspektoratin e Mjedisit, për rritjen e numrit të kontrolleve në zonat ku paraqiten më shumë probleme, e sidomos në Zonën e Mbrojtur dhe Peizazhi i Mbrojtur, në lidhje me rastet e shfrytëzimit dhe të tregtimit të paligjshëm të materialit drusor, të prodhimeve pyjore e jo pyjore.

Menjëherë

14. Të hartohet plan veprimi midis DSHP Tiranë dhe ARM, për ushtrimin e kontrolleve në të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fondin pyjor e kullosor, për dokumentacionin ligjor që ato duhet të kenë dhe pajisjen e tyre me dokumentacionin përkatës të nevojshëm për ushtrimin e aktivitetit të tyre, si: karriera ndërtimi (gurore e lavatriçe), antenat e kompanive celulare, lokale, etj. Të merren masa për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në funksion të shfrytëzimit të pasurisë me interes publik dhe shtet.

Menjëherë

15. Të merren masa për disiplinimin dhe vënien para përgjegjësisë të individëve etj, që shfrytëzojnë pa kriter nënproduktet e pyllit, pa lidhur kontrata me DSHP, në zbatim të nenit 3, të ligjit nr. 7792,

datë 15.6.1993 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”, duke i kallëzuar dhe penalisht ata.

Vazhdimisht

16. Nga DSHP-ja, të merren masa për të llogaritur dhe publikuar kapacitetin e prodhimeve të dyta pyjore, si dhe shfrytëzimi i tyre të realizohet nga subjektet private të specializuara dhe përzgjedhja e subjekteve të bëhet nëpërmjet ankandeve, të organizuar nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor Tiranë.

Menjëherë

17. Të rritet bashkëpunimi me pushtetin vendor për ruajtjen, mbrojtjen e pyjeve dhe zbatimin e ligjshmërisë në fushën e pyjeve, pavarësisht nga forma e pronësisë, si dhe të hartohen programe bashkëpunimi midis DSHP dhe të gjitha komunave.

Vazhdimisht

18. Nga DSHP-ja të ushtrohen kontrole të vazhdueshme, tematikë, si dhe në bashkëpunim me organet e tjera ligjzbatuese në qendrat e përpunimit, të shitjes së materialeve drusore, të prodhimeve të dyta pyjore, si dhe bimëve eterovajore.

Vazhdimisht

19. Në zbatim të Strukturës së re Organizative të ardhur nga Ministria e Mjedisit për vitin 2014, të merren masa për hartimin e Rregullores së Brendshme, ku të pasqyrohen të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të kësaj drejtorie, si dhe mënyra e vlerësimit të performancës së çdo punonjësi, në raport me pozicionin e përcaktuar në strukturë, si dhe paraqitjen për miratim në Ministrinë e Mjedisit dhe Pyjeve.

Menjëherë

20. Të bëhen inventarizim i pasurisë së Institucionit dhe nga Seksioni i Financës për vitet në vazhdim, të mbahen në kontabilitet inventarët fizik dhe kontabël të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara.

Menjëherë

21. Nga Seksioni i Financës të merren të gjitha masat organizative në mënyrë që veprimtaria ekonomiko-financiare e DSHP, për vitin 2014 e në vazhdim, të jetë e pasqyruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, si dhe Urdhrit të Ministrisë së Financave nr. 4292, datë 15.06.2006 “Për shpalljen e standardeve kontabël kombëtare dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”.

Menjëherë

22. DSHP të marrë të gjitha masat tekniko-organizative për implementim e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, duke e përfshirë edhe në Rregulloren e Brendshme për vitin 2014 e në vazhdim.

Menjëherë

23. Nga DSHP-ja të analizohet dhe të detajohet vlera prej **72,634,382 lekë** që rezulton në aktiv në llogarinë 468-Debitorë të ndryshëm, që nga momenti i krijimit të tyre. Nga drejtoria për çdo muaj të analizohet materiali i përgatitur nga juristja për zbatimin e nenit 46-Parashkrimi i dënimit administrativ të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe ti paraqitet material organit administrativ, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjet administrative, i cili po me vendim duhet të konstatojë parashkrimin. Në vendimin, ku konstatohet parashkrimi i dënimit administrativ, listohen edhe arsyet që kanë çuar në këtë përfundim, bazuar kjo edhe në materialin e paraqitur nga juristja e DSHP-së.

Menjëherë

24. DSHP të bashkëpunojë me Ministrinë e Mjedisit për të eliminuar nga degradimi dhe kalbja e gjithë lëndës drusore që rezulton në zonat e përshkuara nga zjarret, dhe të bëhen të gjitha përpjekjet për të zgjidhur shitjen e lëndës drusore të përdorshëm për shfrytëzim në volumen prej 12,236 m³, e vlerësuar në lëndë punimi 7,286 m³ dhe dru zjarri 4,950 m³.

Menjëherë

25. DSHP dhe Ministria e Mjedisit dhe Pyjeve, si dhe përmes Ministrisë së Ekonomisë të kërkojnë duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore, për detyrimin e subjektit "██████" për të realizuar mbjelljen me fidana pyjore të sipërfaqes prej 10 ha, që përcakton VKM nr. 516, datë 06.07.2011 "Për heqjen nga fondi pyjor e kullosor të sipërfaqeve nga ngastrat e ekonomisë pyjore Fagë dhe Krrabë Gurrë, Tiranë, që do të përdoret nga shoqëria "██████" për ndërtimin e "██████"

Menjëherë

26. DSHP në zbatim të VKM nr. 1080, datë 22.12.2010 "Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve", të marri të gjitha masat tekniko-organizative për parandalimin dhe zbulimin në kohë të vatrave të zjarrit si dhe shuarjen e tyre. Ti kërkohet Ministrisë së Mjedisit fonde për funksionimin dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe për ngritjen e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve.

Menjëherë

27. DSHP Tiranë ti kërkojë Ministrisë së Mjedisit dhe Pyjeve, rivlerësimin e gjendjes fizike si dhe dëmtimet që ka pësuar Qendra e Vizitorëve, Dajt, me qëllim planifikimin e saktë me fonde për sjelljen e saj në gjendje normale për të qenë atraktive për vizitorët.

Menjëherë

28. Nga DSHP Tiranë të merren masa të menjëhershme që vërtetimet e transportit të firmosura nga personat të cilët nuk janë në marrëdhënie pune me DSHP-në të kthehen mbrapsht duke i bërë të pavlefshme dhe të furnizohen me bllok të ri me të njëjtën pagesë.

Menjëherë

Për Ministrinë e Mjedisit:

1. Bazuar në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", nga Ministria e Mjedisit të rivlerësohet dhe të shpallet akt absolutisht i pavlefshëm urdhri i ministrit nr. 480, datë 08.06.2010, në të cilin përcaktohet shprehimisht: *"Emërimin, lirimin dhe lëvizja e të gjithë punonjësve të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor do të bëhet vetëm me urdhër të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave sipas propozimeve të drejtorive përkatëse në Ministri, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit"*.

Argumentimi:

Së pari: Urdhri i mësipërm i Ministrit të MMPAU me nr. 480, datë 08.06.2010, dërguar në DSHP me shkresën nr. 2808, datë 07.06.2010, është i kundërligjshëm për arsye se bie ndesh me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar

Së dyti: Urdhri i mësipërm i Ministrit të MMPAU përcakton se është nxjerrë në zbatim të nenit 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 173, datë 26.11.2009 "Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave".

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është akti themelor i çdo shteti, burimi më kryesor i së drejtës dhe korniza e të gjitha akteve (burimeve) të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Asnjë akt tjetër nuk mund të tejkalojë apo të ndryshojë të drejtat e parashikuara në Kushtetutë.

- Në zbatim të dispozitave kryesore kushtetuese Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, ligj organik i cili përcakton të drejtat dhe detyrimet lidhur me marrëdhëniet e punës.

Së treti: Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe shërbimin Pyjor”, të ndryshuar me ligjin nr. 9533, datë 15.05.2006 “Për disa ndryshime ne ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, në nenin 9, pika 1 përcakton shprehimisht:

“Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrit të Ujërave është organi më i lartë administrativ i shërbimit pyjor. *Drejtorët e Drejtorive Rajonale të Shërbimit Pyjor* emërohen nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrit të Ujërave”.

Pra ligji i mësipërm i lë tagër ministrit vetëm për të emëruar drejtorët dhe jo gjithë punonjësit e DSHP-ve.

Së katërti: Me urdhrin e mësipërm të Kryeministrit është miratuar struktura dhe organika e MMPAU dhe nuk i delegohet ministrit kompetenca për marrjen dhe largimin nga puna të gjithë punonjësve të DSHP-ve.

Së pesti: Urdhri i mësipërm i ministrit bie ndesh me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar Kreu IV, Neni 11- pika 1-Të drejtat dhe detyrimet lidhur me marrëdhëniet e punës të cilat rregullohen sipas rendit të burimeve të përcaktuara të së drejtës, si dhe bazuar në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Koment:

a. Neni 11, paragrafi 1 vendos hierarkinë e normave. Normat inferiore duhet të jenë konform normave superiore, në të kundërt janë të pavlefshme, me përjashtim të rasteve kur kundërshtia me normat superiore është në favor të punëmarrësve. Ky paragraf ka si burim të drejtë edhe Rregulloren e Punës, me kusht që të respektojë Kodin e Punës, aktet nënligjore, kontratën kolektive dhe atë individuale. Në këtë mënyrë, punëdhënësit, sidomos DSHP-të mund të rregullojnë kushtet e punës në mënyrë të detajuar me anë të rregullores së punës. Shkelja e Rregullores nga ana e punëmarrësit mund të përbëjë shkak të justifikuar për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës sipas nenit 153 të Kodit të Punës.

b. Nga DSHP-ja është hartuar një Rregullore e Brendshme me shumë të meta e cila nuk është miratuar nga MMPAU, fakt ky që tregon se në DSHP Tiranë mungon Rregullorja e Brendshme, pasi ajo nuk është e miratuar nga ministri i MMPAU dhe për më tepër në të nuk janë përfshirë detyrimet dhe të drejtat punëdhënësit dhe punëmarrësve në zbatim të Kodit të Punës.

c. Ky nen përkufizon kontratën e punës, dhe nga ky përkufizim rrjedhin katër elementë kryesore të përcaktuara në nenin 12 të Kodit të Punës dhe konkretisht:

i. Punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e tij me “punë” ose “shërbim”, për të cilat kuptojmë çdo lloj aktiviteti manual apo intelektual.

ii. Punëmarrësi ofron punën në një periudhë të caktuar apo të pacaktuar kohe. Në kontratën e punës, punëmarrësi i ofron punëdhënësit kohën e tij, pra i vë në dispozicion kohën dhe rezultatin e një aktiviteti.

iii. Punëmarrësi ofron punën ose shërbimin e tij në kuadrin e organizimit dhe të urdhrave të punëdhënësit. Varësia e punëmarrësit nga punëdhënësi është edhe elementi thelbësor i kontratës së punës. Varësia manifestohet zakonisht në **tre aspekte:**

- Në aspektin kohor, punëmarrësi respekton orarin e përcaktuar nga punëdhënësi.
- Në aspektin hapësinor, punëmarrësi punon në vendin e punës së caktuar nga punëdhënësi.
- Në aspektin hierarkik, punëmarrësi punon sipas urdhrave dhe udhëzimeve të punëdhënësit.
- Punëmarrësi i kryen shërbimin e tij kundrejt një shpërblimi. Paga është elementi i katërt thelbësor i kontratës së punës.

Për sa trajtuam më sipër rezulton se punëdhënësi është drejtori, i cili kryer dhe drejtimin dhe organizimin e punës në DSHP.

Së gjashti: Të gjitha kontratat e lidhura me punonjësit në zbatim të neneve 664-678 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 12 të ligjit nr. 7961,

datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar janë lidhur nga drejtori i DSHP.

Së shtati: Urdhrat e ministrit për largim nga puna mbi bazën e propozimeve të bëra nga drejtorët e DSHP Tiranë për vitet 2012-2013 kanë krijuar një dëm ekonomik prej **8,009,537 lekë, për faktin se janë rrëzuar nga gjykatat me vendim të formës së prerë.**

Së teti: Në nenin 140 e vijues në kreun e XIV të Kodit të Punës janë sanksionuar rregullimet ligjore të përfundimit të marrëdhënieve të punës të cilat, krahas të tjerave, karakterizojnë garanci mbrojtëse që synojnë të parandalojnë qëndrimet e pamotivuara të largimit nga puna nga ana e punëdhënësit, duke siguruar në këtë mënyrë mbrojtjen e interesave të punëmarrësit.

Sipas nenit 141 të Kodit të Punës, kontrata e punës i njej të drejtën punëdhënësit po ashtu dhe punëmarrësit për zgjidhjen e kontratës së punës, por gjithnjë kjo e drejtë e tyre nuk mund të cenojë të drejtat dhe interesat e palës tjetër. Në këto kushte në Kodin e Punës janë parashikuar rregullat e detyrueshme për palët, që duhet të respektohen, në atë mënyrë që e drejta e zgjidhjes së kontratës së punës nga njëra anë, realizon dhe mbrojtjen e palës tjetër që ndodhet përpara kësaj zgjidhje.

Së nënti: Të gjitha urdhrat për largim nga puna, të **82 punonjësve**, nga të cilët të cilët 9 prej tyre kanë fituar të drejtat e tyre nga gjykatat, janë dhënë të pajustifikuara, pa shkaqe të arsyeshme dhe në kundërshtim me Kodin e Punës dhe përkatësisht me:

“Dispozitën e pikës 3 të nenit 146 dhe pikës 3 të nenit 155, të cilat parashikojnë: **“Neni 146, pika 3. e cila përcakton shprehimisht:**

“Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme është e pavlefshme. Punëdhënësi që ka zgjidhur kontratën pa shkaqe të arsyeshme detyrohet t’i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në një vit pagë, që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim gjykate të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim”.

“Neni 15, pika 3, përcakton shprehimisht:

“Në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të pajustifikuar të kontratës së punës nga punëdhënësi, gjykata, duke vlerësuar të gjitha rrethanat, vendos detyrimin e punëdhënësit ndaj punëmarrësit me një dëmshpërblim jo më shumë se paga e një viti pune. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim”.

Koment:

- Shkaku i justifikuar, sipas fushës së zbatimit, ka natyrë reale, pra sjell mungesën e pasojave të pushimit të pajustifikuar. Natyra e detyruar, me pasojë shuarjen e marrëdhënieve të punës, ka sjell për pasojë për rastet e mësipërme detyrimin e punëdhënësit për pagimin e dëmit deri në një vit pagë, plus shtesat përkatëse që i përkasin afatit të njoftimit (neni 146/3 i Kodit të Punës). Pra fusha e pushimit nga puna, pa nevojën e një motivacioni është prezent për aq kohë sa Kodi i Punës parashikon sa sipërcituar. Kodi i Punës shprehet qartë se çfarë bëhet kur zgjidhet kontrata pa shkaqe të arsyeshme (neni 146/3 si dhe neni 155/3 i Kodit të Punës).

- Punëdhënësi dhe punëmarrësi, edhe në kuadër të procedurës civile, janë në pozita të caktuara procedurale, njëri paditës dhe tjetri i paditur në një proces gjyqësor ku njëra palë pretendon diçka, ndërsa pala tjetër ka të drejtë të prapësojë ato pretendime, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit (nenet 19-21 të K.Pr.C).

- Fakti i paraqitjes në gjykatë të 9 punonjësve (punëmarrës) dhe argumentimi i provave para trupit gjykues vërteton se largimet nga puna të tyre kanë qenë të paargumentuara ligjërisht dhe në kundërshtim me Kodin e Punës.

Së dhjetë: Në mënyrë më analitike problemet e trajtimit për marrjen dhe largimin nga puna të punonjësve të cilët trajtohen me Kod Pune janë trajtuar me:

- Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 12.09.2007;

- Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 31, datë 14.4.2003;
- Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 19, datë 15.11.2007;
- Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 7, datë 01.06.2011.

Për sa argumentuam me sipër rezulton se Urdhri i mësipërm i Ministrit të Mjedisit me nr. 480, datë 08.06.2010, dërguar në DSHP me shkresën nr. 2808, datë 07.06.2010, është i **kundërligjshëm** për arsye se bie ndesh me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

Konkluzion:

Për sa më sipër rezulton që urdhri i mësipërm i Ministrit të MMPAU i kapërcen kompetencat ligjore për arsye se bie ndesh me Kodin e Punës.

Menjëherë

2. Duke gjykuar se me ndryshimet e thella që ka pësuar gjendja juridike e fondit pyjor dhe kullor kombëtar, nëpërmjet transferimit të tyre në pronësi të organeve të qeverisjes vendore si dhe privatëve, të cilat nuk janë shoqëruar me akte ligjore dhe nënligjore ku të përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrimet e këtyre organeve, në drejtim të administrimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të këtij fondi. Duke gjykuar se aktet ligjore në fuqi kanë mangësi të theksuara si dhe ekuivoke në interpretimin e tyre, propozojmë që nga Ministria e Mjedisit të hartohet një paketë e re aktesh ligjore, për rregullimin dhe funksionimin ligjor të administrimit dhe zhvillimit të fondit pyjor dhe kullor kombëtar.

Menjëherë

3. Nga Ministria e Mjedisit të hartohet Rregullore e Brendshme për gjithë Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Pyjor, ku në të jenë përfshirë gjithë përgjegjësitë dhe detyrimet për çdo seksion e punonjës, objektivat si dhe mënyra e vlerësimit të performancës, detyrimet dhe të drejtat punëdhënësit dhe punëmarrësve në zbatim të Kodit të Punës, pasi mungesa e plotë e kësaj rregulloreje për të gjithë punonjësit ka influencuar mjaft negativisht në drejtimin, organizimin, koordinimin, përgjegjësitë e çdo punonjësi, si dhe largimet e shpeshta nga puna ka bërë që të shmanget dhe nxjerrja e përgjegjësisë ndaj punonjësve.

Menjëherë

4. Të hartohet plan veprimi midis Ministrisë së Mjedisit, DSHP Tiranë dhe ARM, për listimin e saktë dhe elektronikisht me qëllim ushtrimin e kontrolleve në të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fondin pyjor e kullor, për dokumentacionin ligjor që ato duhet të kenë kriteret ligjore e teknike që duhet të plotësojnë si: karriera ndërtimi (gurore e lavatriçe), antenat e kompanive celulare, lokale, etj.

Menjëherë

5. Ministria e Mjedisit dhe Pyjeve, si dhe përmes Ministrisë së Ekonomisë të kërkojnë duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore, për detyrimin e subjektit [REDAKTUAR] për të realizuar mbjelljen me fidana pyjore të sipërfaqes prej 10 ha, që përcakton VKM nr. 516, datë 06.07.2011 “Për heqjen nga fondi pyjor e kullor të sipërfaqeve nga ngastrat e ekonomisë pyjore Fagë dhe Krrabë Gurrë, Tiranë, që do të përdoret nga shoqëria [REDAKTUAR] për ndërtimin e [REDAKTUAR]

Menjëherë

6. Ministria e Mjedisit në zbatim të VKM nr. 1080, datë 22.12.2010 “Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve”, të marri të gjitha masat tekniko-organizative për planifikimin me fonde për DSHP Tiranë, për shpenzimet për funksionimin dhe përmirësimin e infrastrukturës për shuarjen e zjarreve, si dhe për ngritjen e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve.

Menjëherë

7. Ministria e Mjedisit, të planifikojë në buxhetin vjetor të saj fond operativ për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri, në realizim dhe zbatim të kërkesave që përmban pika nr. 17, e VKM nr. 1080, datë 22.12.2010, si dhe të vendosë në dispozicion të DSHP Tiranë sipas nevojave.

Menjëherë

8. Ministria e Mjedisit të hartojë planet e menaxhimit për Parkun Kombëtar të Malit të Dajtit sipas zonave dhe të marrë masa për funksionimin e Komitetit të Menaxhimit për zonën e mbrojtur.

Menjëherë

9. DSHP Tiranë ti kërkojë Ministrisë së Mjedisit dhe Pyjeve, çeljen e fondeve për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave pronë shtetërore, të kërkojë fonde operative për shërbime të nevojshme në drejtim të luftës ndaj erozionit, si dhe shërbimeve silvikulturore në pyje.

Menjëherë

10. Ministria e Mjedisit dhe Pyjeve, me grup pune të veçantë të kryejë rivlerësimin e gjendjes fizike si dhe dëmtimet që ka pësuar Qendra e Vizitorëve, Dajt, me qëllim planifikimin e saktë me fonde për sjelljen e saj në gjendje normale, për të qenë atraktive për vizitorët.

Menjëherë

11. Ministria e Mjedisit të marrë masa për të hartuar plane të menaxhimit, për Parkun Kombëtar të Malit të Dajtit dhe Peizazh i Mbrojtur të ndodhur në Malin me Gropa-Bizë-Martanesh, si dhe për sipërfaqen pronë shtetërore të ndodhur në këto zona, duke planifikuar dhe fondet përkatëse, bazuar në planet e mbarështimit.

Menjëherë

12. Ministria e Mjedisit të bashkëpunojë me DSHP Tiranë, për të eliminuar nga degradimi dhe kalbja gjithë lëndën drusore që rezulton në zonat e përshkuara nga zjarret, duke miratuar shitjen e lëndës drusore të përdorshëm për shfrytëzim në volumn prej 12,236 m³, e vlerësuar në lëndë punimi 7,286 m³ dhe dru zjarri 4,950 m³.

Menjëherë

13. Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me Inspektoratin Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, të marrë masa dhe të ndjekë rrugët ligjore për kthim në gjendjen e mëparshme të sipërfaqeve të zaptuara e të zëna me ndërtime pa leje si dhe të marrë masa për mbylljen e aktiviteteve shfrytëzim gurore në territorin e Parkut Kombëtar të Malit të Dajtit.

Brenda vitit 2012

14. Të merren masa në bashkëpunim me Qarkun dhe NjQV për të saktësuar kufijtë administrativ të NjQV dhe saktësimin përfundimtar të inventarëve të pyjeve dhe kullotave.

Menjëherë

15. Të merren masa për të realizuar dixhitalizimin e hartave të ekonomive Pyjore dhe Kullosore, nga sektori i kadastrës në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, pranë Ministrisë së Mjedisit.

Brenda vitit 2012

16. Të merren masa për të miratuar rregulloren e paraqitur nga DSHP Tiranë, për administrimin dhe ruajtjen e Zonës së Mbrojtur Mali i Dajtit.

Të merren masa për të bërë funksional, Komitetin e Menaxhimit, në lidhje me zbatimin e planit të menaxhimit të zonës, ruajtjen e cilësisë së zonës dhe nxitjen e zhvillimit ekologjik të mjediseve përreth saj dhe zbatimin e kërkesave për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore të zonës.

Menjëherë

17. Në zbatim të ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura” të ndryshuar”, Ministria e Mjedisit të bashkëpunojë me Ministrinë e Ekonomisë dhe Energjetikës, për të shfuqizuar lejet minerale të dhëna subjekteve për shfrytëzimin e guroreve në “Zonat e Mbrojtura”.

Menjëherë

18. DSHP të marri masa dhe ti kërkojë Ministrisë së Mjedisit dhe Pyjeve fondet e nevojshme për të bërë regjistrimin e Fondit Pyjor pronë shtetërore, në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga Drejtoria Shërbimit Pyjor, Tiranë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit, për shpërblimin e dëmit në vlerën **442,813 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. **Vlera prej 270,628 lekë** përfituar pagë në mënyrë të padrejtë nga 12 punonjës të emëruar dhe të kontraktuar nga Titullari i institucionit nëpërmjet akteve administrative të kundërligjshme si dhe paguar nga nëpunësi zbatues në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 neni 8 pika 8/d, neni 12 pika a,e, neni 13,14 dhe me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik” Kapitulli “Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlerë” pika 71. *(Trajtuar në procesverbalin nr. 6, datë 02.05.2014)*

Shumat detyrim për tu ndaluar sipas punonjësve paraqiten në tabelën mëposhtme:

Nr	Emër Mbiemër	Shuma	Nr	Emër Mbiemër	Shuma	Nr	Emër Mbiemër	Shuma
1		21,248	5		15,153	9		36,439
2		24,678	6		19,998	10		30,165
3		14,137	7		33,168	11		18,774
4		16,276	8		15,715	12		24,877
							Shuma	270,628

Menjëherë

2. **Vlera prej 84.000 lekë** nga ish-drejtori [REDAKTUAR], i cili ka nxjerrë urdhrin e prokurimit për blerjen e gomave për herë të dytë në një hark kohor prej 10 muajsh për automjetin të tipit Land Rover në mungesë të dokumentacionit justifikues për domosdoshmërinë e ndërrimit të tyre në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik” pika 10 dhe Urdhrit MF nr. 92, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela1/3. *(Trajtuar në procesverbalin nr. 7, datë 02.05.2014)*

Menjëherë

3. **Vlera prej 72.400 lekë në mënyrë solidare nga** ish Drejtorët [REDAKTUAR], në cilësinë ish Titullarëve të Autoritetit Kontraktor dhe komisionit të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla [REDAKTUAR] për blerjen e pjesëve të këmbimit jo të shërbimit periodik, në mënyrë të përsëritur, çdo 4 muaj për periudhën 2012-2013, për automjetin të tipit Mitsubishi, në mungesë të dokumentacionit justifikues për domosdoshmërinë e ndërrimit të tyre, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik”, pika 10 dhe Urdhrit të MF nr. 92, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela1/3. *(Trajtuar në procesverbalin nr. 7, datë 02.05.2014)*

Menjëherë

4. Vlera prej 15,785 lekë, subjektit [REDAKTUAR] për arsye se nuk janë mbajtur kamat vonesat, sipas kontratës të lidhur më datë 10.07.2013, midis DSHP, përfaqësuar nga titullari dhe subjektit, me vlerë 2.250.000 lekë.

Menjëherë

Ç. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës ti jepet:

“Vërejtje”

2. [REDAKTUAR], me detyrë Inxhinier Pyjesh në Malin e Dajtit dhe i komanduar magazinier.

Në cilësinë e njësisë së hartimit të dokumenteve të ankandit.

- Për mos arkivimin e dosjes së procedurës së ankandit me fitues subjektin “IL Luanesha” sh.p.k. Në dosje nuk disponoheshin dokumentet standarde të ankandit publik për këtë ankand. Në dosje nuk disponohej asnjë procesverbal i punës së komisionit. Në dosje nuk ndodhet formulari i sigurimit të ofertës në masën 2 % të vlerës së vëllimit të materialit drusor që do të shfrytëzohet në fazën e parë të prerjeve, për grupimet e ngastrave pa rrugë autopsyjore, si dhe as sigurim kontrate origjinale.

Ë. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenit 37, 38 dhe 40 të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik nga ana e Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit në kuptim të referencave të Kodit Penal, për personat si më poshtë:

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Tiranë, mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, prokurimi i fondeve publike për mallra dhe shërbime, mbi zbatimin e kërkesave për dhënie me qira të kullotave dhe pyjeve, dhënia në përdorim e fondit pyjor, trajtimi shfrytëzimi dhe shitja e materialeve drusore, prodhimeve pyjore dhe jopyjorë, mbi funksionimin dhe zbatimin e detyrave të policisë pyjore dhe bashkëpunimin e strukturave të shërbimit pyjor me organet e qeverisjes vendore për administrimin dhe zhvillimin e fondit pyjor në pronësi të organeve të qeverisjes vendore dhe sektorin privat, mbi sanksionet e vendosura ndaj subjekteve për dëmet e konstatuara dhe gjobat e vendosura, etj, KLSH ka konstatuar se [REDAKTUAR] me detyrë ish-drejtor i DSHP, për periudhën 13.01.2012 deri 11.04.2013 i cili ka konsumuar figurën e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” për sa më poshtë:

- Mosmbajtjen e kontabilitetit të DSHP-së në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 4292, datë 15.06.2006 “Për shpalljen e standardeve kontabël kombëtare dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, për pasojë bilanci dhe pasqyrat financiare për vitet 2012 dhe 2013, nuk janë reale dhe të besueshme.

- Për mos zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Me neglizhencën e tij dhe të administratës së shërbimit pyjor gjatë vitit 2012, janë krijuar dëme në pyje gjatë vitit 2012 në vlerën prej **54,391 mijë lekë**, nga kjo në zonë të mbrojtur **46,935 mijë lekë** dhe për periudhën nga 02.10.2013 deri më 31.12.2013, në vlerën prej **19,248 mijë lekë**, nga kjo në zonë të mbrojtur **15,005 mijë lekë**.

- Për moszbatim të ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, VKM nr. 402, datë 21.06.2006 “Për shpalljen e ekosistemit natyror të “Malit të Dajtit Park Kombëtar (me sipërfaqe të zgjeruar)”, dhe urdhrin të ministrit të MMPAU nr. 160, datë 24.01.2008 “Për zbatimin e ligjshmërisë”, i dalë në zbatim të ligjeve dhe vendimit të mësipërm, për ndërprerjen e aktivitetit të 13 subjekteve private që shfrytëzojnë gurin gëlqeror në Zonën e Mbrojtur “Mali i Dajtit”.

- Për lejimin e vazhdimin të aktivitetit në mënyrë të kundërligjshme të 34 subjekteve të cilat kanë ndërtuar objekte në fondin pyjor kullor duke krijuar një dëm ekonomik prej **54,200 mijë lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (neni 199/a-Ndërtim i paligjshëm dhe neni 200-Pushtimi i tokës, të cilët përcaktojnë shprehimisht: “Objekt i kundërvajtjes penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar regjimin juridik të tokës d.m.th. përdorimin e saj sipas destinacionit, të mbrojtura posaçërisht në legjislacionin penal nga veprimet kriminale”.

- Duke treguar neglizhencë të theksuar në zbatimin të VKM nr. 516, datë 06.07.2011 “Për heqje nga fondi pyjor e kullor të sipërfaqeve nga ngastrat e ekonomisë pyjore Fagë dhe Krrabë-Gurrë, Tiranë që do të përdoret nga shoqëria [REDAKTUAR] për ndërtimin e HEC-[REDAKTUAR] ku në pikën 1 të këtij vendimi, përcaktohet sipërfaqja që hiqet prej **27,55 ha**, për shkak të ndërtimit të rezervuarit dhe digës, si dhe sipërfaqja prej **1,9 ha** për ndërtimi hidrocentrali. Gjithsej sipërfaqja prej **29,45 ha**. Në pikën 4 të këtij vendimi, theksohet se me hyrjen në fuqi të këtij vendimi subjekti [REDAKTUAR] brenda **3 viteve**, me fondet e veta të pyllëzojë **10 ha** pyje në ngastrat e përcaktuara nga DSHP, në bashkëpunim me njësinë e qeverisjes vendore. Është parashikuar që për vitin 2011-2012 të mbillen **3 ha**, për 2012-2013 të mbillet **3 ha** dhe për vitin 2013-2014 të mbillet **4 ha**. Nga auditimi rezultoi se subjekti [REDAKTUAR] deri në përfundim të periudhës së auditimit nuk ka realizuar asnjë ha mbjellje të planifikuara sipas VKM së mësipërme.

- Për mos zbatim të urdhrin të nxjerrë nga vetë ish-drejtori i DSHP me nr. 763, datë 02.10.2013 me objekt: “Kontroll të hollësishëm për prerjet e paligjshme, në ngastrat e shfrytëzimit në “Parkun Kombëtar Mali i Dajtit” dhe Peizazhin e Mbrojtur “Mali me Gropa-Bizë-Martanesh”, është kryer kontroll me grup pune. Në përfundim të kontrollit është konstatuar se në veçanti në disa zona pyjore, janë shkaktuar prerje e dëmtime të mëdha masive të këtyre pyjeve pa leje të organeve pyjore, përvetësim materiali drusor nga kundërvajtës të pyjeve, shkelje të cilat bien ndesh me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, ligjin nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura” i ndryshuar dhe konkretisht:

i. Në sektorin pyjor Zonë e Mbrojtur “Mali i Dajtit” kanë rezultuar **530** copë drurë të prerë në mënyrë të kundërligjshme dhe të pa mbuluar me procesverbale nga inspektorët e zonës, me vlerë dëmi prej **8,416 mijë lekë**.

ii. Në sektorin pyjor Peizazhi i Mbrojtur “Mali me Gropa-Bizë” kanë rezultuar **1412** copë drurë të prerë në mënyrë të kundërligjshme dhe të pa mbuluar me procesverbale nga inspektorët e zonës, me vlerë dëmi prej **23,967 mijë lekë**.

Kjo vepër të konsiderohet kundërvajtje penale për arsye se ka shkaktuar pasoja të rënda në fondin pyjor dhe në bazë të nenit 205, të Kodit Penal përbën kundërvajtje penale. Për shkeljet e mësipërme nga drejtori i DSHP është nxjerrë urdhri për kryerjen e kallëzimit penal por nuk është kryer, veprim ky që tregon **neglizhencë me dashje** në kryerjen e detyrës.

- Në 20 raste vërtetimet e transportit të lëshuara nga DSHP Tiranë dhe të firmosura edhe prej tij, janë të firmosura nga 2 punonjës të cilët nuk janë më në marrëdhënie pune me DSHP-në.

- Procesverbali i rakordimit të vërtetimeve të transportit, procesverbali i rakordimit të faturave tatimore, procesverbali i sasisë së materialit drusor të transportuar për periudhën 28.08.2013 - 17.09.2013, procesverbali i sasisë së materialit drusor të transportuar për periudhën 14.10.2013 -

31.10.2013, janë të firmosura deri më datë 29.12.2013 edhe nga një person që i ka prerë marrëdhëniet financiare me DSHP-në më datë 03.07.2013.

Firmosja e vërtetimeve të transportit të lëshuara nga DSHP Tiranë dhe procesverbalit të rakordimit të faturave tatimore, procesverbalit të sasisë së materialit drusor të transportuar nga persona të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet financiare me këtë institucion lë shteg për abuzime.

II. Në zbatim të urdhrit të drejtorit të DSHP nr. 763, datë 02.10.2013 me objekt: “Kontroll të hollësishëm për prerjet e paligjshme, në ngastrat e shfrytëzimit në “Parkun Kombëtar Mali i Dajtit” dhe Peizazhin e Mbrojtur “Mali me Gropa-Bizë-Martanesh”, është kryer kontroll me grup pune dhe janë konstatuar se:

- në disa zona pyjore janë shkaktuar prerje e dëmtime të mëdha masive të këtyre pyjeve pa leje të organeve pyjore, përvetësimi material drusor nga kundërvajtës të pyjeve, shkelje të cilat bien ndesh me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, dhe ligjin nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura” i ndryshuar. Si rrjedhojë evidentohet se:
- **Së pari:** Sipas ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura” i ndryshuar dhe VKM nr. 108, datë 27.01.2009 “Për kriteret e cilësimit të shkeljeve me pasoja të rënda në pyje”, dëmet e mësipërme janë kryer në një Zonë të Mbrojtur dhe mbështetur në pikën 1 shkronja “a” dhe “ç” të këtij vendimi drurët e prerë janë në zonë të mbrojtur të rëndësisë së veçantë.
- **Së dyti:** Në këto zona të mbrojtura është prishur uniformiteti dhe peizazhi i pyllit.
- **Së treti:** Si rezultat i prerjeve të drurëve janë krijuar çeltira të cilat bëhen shkak për favorizimin e erozionit dhe hedhjen e mbeturinave rreth vendit të prerjes e cila favorizon rënien e zjarreve.
- **Së katërti:** Ulet kurorëdëndësia e sipërfaqes së pyllit.
- **Së pesti:** Një nga agresionet më të mëdha mjedisore që po vuan DSHP Tiranë është prerja e pakontrolluar e pyjeve. Fakti i thjeshtë i prerjes në mënyrë të paligjshme (pa autorizim ose në kohën e vendin e ndaluar) përbën një vepër penale kur nuk përbën një shkelje administrative.

Dëmet e shkaktuara në këto zona kanë ardhur si rezultat i mosveprimeve dhe moskryerjes së detyrave nga punonjësit e ngarkuar institucionalisht me ato detyra dhe në zbatim të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, këta kanë toleruar dhe mos ndëshkuar veprimet e paligjshme të subjekteve apo individëve e si rrjedhojë prezumohet të kenë kryer konsumin të shpërdorimit të detyrës, parashikuar sipas nenit 248 i Kodit Penal. Këta punonjës renditen si më poshtë:

A. Sektori Pyjor Parku Kombëtar “Mali i Dajtit”.

1. [REDAKTUAR], me detyrë inspektor në zonën pyjore “Shkallë”.

Numri i drurëve të prerë pa leje dhe të pambuluar me procesverbale në këtë ekonomi rezulton 325 copë dru, nga të cilat 111 copë të llojit Ah dhe 214 copë të llojit Lis. Nuk ka mbajtur asnjë procesverbale me kundërvajtësit. Vlera e dëmit në total **4,080,000 lekë**.

2. [REDAKTUAR], me detyrë inspektor në zonën pyjore “Selita 2”.

Numri i drurëve të prerë pa leje dhe të pambuluar me procesverbale në këtë ekonomi rezulton 205 copë dru. Vlera e dëmit **4,336,000 lekë**.

B. Peisazhi i Mbrojtur “Mali me Gropa-Bizë-Martanesh”.

1. [REDAKTUAR], me detyrë inspektor në zonën pyjore “Brosh-Bardhet-Linas”.

Numri i drurëve të prerë pa leje dhe të pambuluar me procesverbale rezulton 335 copë dru, duke u shkaktuar një dëm prej **5,145,000 lekë**.

2. [REDAKTUAR] me detyrë inspektor në zonën pyjore “Bizë”.

Numri i drurëve të prerë pa leje dhe të pa mbuluar me procesverbale në këtë ekonomi rezulton 536 copë dru. Vlera e dëmit **9,259,000 lekë**.

3. [REDAKTUAR], me detyrë inspektor në zonën pyjore “Kostenjë-Fushë-Gurrë”.

Numri i drurëve të prerë pa leje dhe të pambuluar me procesverbale rezulton 541 copë dru. Vlera e dëmit **9,563,000 lekë**.

4. [REDAKTUAR], me detyrë përgjegjës sektori i Peizazhit të Mbrojtur “Mali me Gropa-Bizë - Martanesh”. Në këtë sektor numri i drurëve në total të prerë pa leje dhe të pa mbuluar me procesverbale rezulton 1,412 copë dru me një vlerë dëmi prej **23,967,000 lekë**.

Shënim:

A. Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin Përfundimtar të Auditimit janë konstatuar përgjegjësi të natyrës manaxhuese dhe administrative për:

1. [REDAKTUAR] me detyrë ish Përgjegjëse e Seksionit të Financës, për:

- Pagesën e 12 punonjësve nëpërmjet akteve administrative të kundërligjshme **në vlerën prej 270,628 lekë e cila përbën dëm ekonomik**, pasi është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 8 pika 8/d, neni 12 pika a, e, neni 13,14 dhe me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik” Kapitulli “Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlerë” pika 71.

- Për vitin 2013 në dy raste listëpagesat të muajit shtator 2013, nëntor 2013, nuk janë të shoqëruara me listëprezenca.

- Shpërndarja e karburantit pa destinacion, dhënia e karburantit për mjete private, pa asnjë dokumentim të qëllimit të këtij shpenzimi, janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për sistemin dhe mbajtjen e kontabilitetit në kundërshtim me ligjin 9248, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, nuk është hapur ditari i veprimeve të bankës për shpenzimet sipas destinacionit, nuk është mbajtur ditari i veprimeve nëpërmjet magazinës, nuk ka ditar të veprimeve të ndryshme, nuk ka dokumentacion mbështetës se si janë kryer veprimet dhe si janë prerë artikujt kontabël për të kaluar nga ditari në bilanc, nuk është mbajtur sistemi centralizator për kontabilizimin e gjithë veprimeve të aktivitetit ekonomik financiar, në bazë të të cilave do të hartohet bilanci, nuk janë hapur librat e aktiveve dhe azhurnimet përkatëse, për llojet e ndryshme të aktiveve.

2. [REDAKTUAR], me detyrë ish-Specialist i Seksionit të Financës.

3. [REDAKTUAR], me detyrë inxh-pyjesh në Seksionin e Policisë, për:

Në cilësinë e anëtarëve të komisionit të blerjeve me vlera të vogla

- Për vitin 2012, nga 12 raste prokurimi me blerje me vlera të vogla, vetëm në dy raste është zhvilluar prokurim elektronik, në kundërshtim me **udhëzimin nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, pika 5 e tij.**

- Për vitin 2012, janë bërë pagesa në 7 raste në vlerë 681,000 lekë, ku faturat tatimore të lëshuara nga furnitori nuk janë firmosur nga 2 anëtarë të Komisionit të blerjeve me vlera të vogla.

- në 4 raste, me vlerë 405,150 lekë, procedura të blerjes me vlera të vogla janë bërë fiktive, blerjet janë kryer më parë se të dalë urdhri i prokurimit.

- Për realizimin e procedurës së prokurimit për blerje me vlera të vogla pa objekt, për 4 raste në shumën 578,900 lekë, për “Riparim plus pjesë këmbimi për makinën Mitsubish”, ku në tre raste nuk kishte akt konstatimi të defekteve nga specialistë të fushës, për përcaktimin e nevojave për kryerjen e këtyre shërbimeve, pa pasur të saktësuar objektin e prokurimit.

- Në të katër rastet e procedurave të blerjeve me vlera të vogla për “Riparim plus pjesë këmbimi për makinën Mitsubishi”, ka zëra të njëjtë punimesh, të përsëritura afërsisht çdo 4-5 muaj, të **paargumentuara me pasojë dëmin ekonomik prej 72,800 lekë**,

- në 5 raste, në shumën 426,800 lekë, procedurat e prokurimit për blerje me vlera të vogla për riparim kompjuterë e printerë, ka zhvilluar procedurën e blerjes me vlera të vogla në bazë të një urdhri të pasaktë, ku nuk përcaktohen marka e kompjuterit, të cilët do t'i bëhet riparimi, ku për marka të ndryshme specifikime të ndryshme dhe çmime të ndryshme, në kundërshtim me Urdhrin nr. 92, të Ministrisë së Financave, datë 29.12.2011, “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, dhe me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, i cili në kreun VI, pika 2, “Prokurimi me vlera të vogla” në nën pikën “b”,

- Në dy raste me vlerë 315,000 lekë, janë realizuar procedura për “Blerje për rimbushje fikse zjarri”, urdhrat e prokurimit kanë dalë pa pasur më parë kërkesë dhe plan vendosje të tyre si dhe mungon specifikimi teknik, nuk përcaktohet lloji i rimbushjes. Në procesverbalin e shqyrtimit dhe të vlerësimit të ofertave nuk përcaktohet nëse malli i blerë është shkume apo pluhur. Për këtë blerje specifike nuk është kërkuar asnjë licencë për tregtimin e tyre.

B. Ndërsa punonjësit në cilësinë e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ankandit:

1. [REDAKTUAR], me detyrë ish-juriste në Seksionin e Policisë Pyjore;
2. [REDAKTUAR], me detyrë ish-Inspektor i Seksionit të Menaxhimit;
3. [REDAKTUAR], me detyrë ish-Përgjegjës i Seksionit të Menaxhimit;
4. [REDAKTUAR], me detyrë ish-Përgjegjësi i Seksionit të Financës;
5. [REDAKTUAR], me detyrë punonjëse e Sektorit të Kadastrës në Seksionin e Menaxhimit;
6. [REDAKTUAR] me detyrë inxh-pyjesh në Seksionin e Menaxhimit të cilët:

- Për mosdisponimin e dokumenteve të ankandit publik, të procesverbaleve të punës së komisionit të ankandit, mungesa e sigurimit të ofertës dhe kontratës origjinale, vlerësimin e gabuar të kontratës së qerasë, për dy mjete e cila **nuk e mbulon afatin e kontratës së lidhur midis palëve për** mjetet e deklaruara në pronësi, me përjashtim të një rasti, nuk ka në dosje leje qarkullimi.

Meqenëse punonjësit e mësipërm janë larguar nga puna mendojmë të mos të japim masa disiplinore, për arsye se ato quhen të ezuruara.

C. Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin Përfundimtar të Auditimit janë konstatuar përgjegjësi të natyrës drejtuese dhe manaxhuese edhe për:

1. [REDAKTUAR], në cilësinë e ish-drejtorit të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Tiranë, për:
 - Pagesën e 12 punonjësve nëpërmjet akteve administrative të kundërligjshme **në vlerën prej 270,628 lekë e cila përbën dëm ekonomik**, pasi është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 8 pika 8/d, neni 12 pika a,e, neni 13,14 dhe me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik” Kapitulli “Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlerë” pika 71.
 - Shpërndarja e karburantit me autorizime të tij, nuk ka përcaktuar destinacionet e lëvizjeve dhe qëllimin për të cilin bëhet ky shpenzim. Në 12 raste, për dy vitet objekt auditimi, i janë dhënë karburant personave privatë (punonjës të Institucionit), me autorizim prej tij, për të cilët nuk është dhënë asnjë justifikim përse janë marrë, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
 - Në 20 raste vërtetimet e transportit të lëshuara nga DSHP Tiranë dhe të firmosura edhe prej tij, janë të firmosura nga 2 punonjës të cilët nuk janë më në marrëdhënie pune me DSHP-në.
 - Procesverbali i rakordimit të vërtetimeve të transportit, procesverbali i rakordimit të faturave tatimore, procesverbali i sasisë së materialit drusor të transportuar për periudhën 28.08.2013 - 17.09.2013, procesverbali i sasisë së materialit drusor të transportuar për periudhën 14.10.2013-

31.10.2013, janë të firmosura deri më datë 29.12.2013 edhe nga një person që i ka prerë marrëdhëniet financiare me DSHP-në më datë 03.07.2013.

- Urdhrat e prokurimit për blerje me vlera të vogla, të cituara në Raportin e Auditimit, të Titullarit të AK, Hidër Goga, janë hartuar pa kërkesë apo procesverbal për nevojën e blerjes apo shërbimit dhe në mungesë të përcaktimit të saktë objektit të prokurimit.

- Urdhri i ankandit nr. 1/1, nr. prot 142/2, datë 25.04.2013, me fitues subjektin [REDAKTUAR] nuk ka të përcaktuar objektin e ankandit, në kundërshtim me VKM nr. 1719, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, Kreu V.

- Nuk janë mbajtur kamat vonesë në shumën **15,785 lekë**, sipas kontratës të lidhur më datë 10.07.2013, midis DSHP, përfaqësuar nga titullari dhe subjektit “IL Luanesha” sh.p.k. me vlerë 2.250.000 lekë.

2. [REDAKTUAR], në cilësinë e ish-drejtorit të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Tiranë, për:

- Urdhrin e prokurimit për blerjen e gomave për herë të dytë në një hark kohor prej 10 muajsh për automjetin të tipit Land Rover në mungesë të dokumentacionit justifikues për domosdoshmërinë e ndërrimit të tyre, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik”, pika 10 dhe Urdhrit MF nr. 92 datë 29.12.2011, “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela1/3.

3. [REDAKTUAR], me detyrë ish-përgjegjësi i Seksionit të Financës në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Tiranë, për:

- Pagesën e 12 punonjësve nëpërmjet akteve administrative të kundërligjshme **në vlerën prej 270,628 lekë e cila përbën dëm ekonomik**, pasi është në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 8 pika 8/d, neni 12 pika a,e, neni 13,14 dhe me UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik” Kapitulli “Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlerë” pika 71.

- për vitin 2012, në 3 raste listëpagesat të muajit shkurt, gusht e dhjetor, dhe për vitin 2013 në 2 raste listëpagesat e muajit maj e shtator, nuk janë të shoqëruara me listëprezenca.

- Shpërndarja e karburantit pa destinacion, dhënia e karburantit për mjete private, pa asnjë dokumentim të qëllimit të këtij shpenzimi, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Nuk janë mbajtur kamat vonesë në shumën **15,785 lekë**, sipas kontratës të lidhur më datë 10.07.2013, midis DSHP dhe subjektit “IL Luanesha” sh.p.k. me vlerë 2.250.000 lekë.

- Për sistemin dhe mbajtjen e kontabilitetit në kundërshtim me ligjin 9248, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, nuk është hapur ditari i veprimeve të bankës për shpenzimet sipas destinacionit, nuk është mbajtur ditari i veprimeve nëpërmjet magazinës, nuk ka ditar të veprimeve të ndryshme, nuk ka dokumentacion mbështetës se si janë kryer veprimet dhe si janë prerë artikujt kontabël për të kaluar nga ditari në bilanc, nuk është mbajtur sistemi centralizator për kontabilizimin e gjithë veprimeve të aktivitetit ekonomik financiar, në bazë të të cilave do të hartohet bilanci, nuk janë hapur librat e aktiveve dhe azhurnimet përkatëse, për llojet e ndryshme të aktiveve. Nga auditimi i bilancit të vitit 2012, rezulton se paraqiten me gjendje llogaritë: 211, “pyje, kullota, plantacione”, 212, “ndërtime, konstruksione”, 213, “rrugë, rrjete e vepra ujore”, 214, “instalime teknike, makineri e pajisje, vegla pune”, në vlerën 24,299,475 lekë, 215, “mjete transporti”, të cilat nuk kanë ndryshuar nga viti paraardhës dhe nuk ka analiza se çfarë përfaqësojnë këto vlera.

- Nuk ka asnjë pasqyrë të llogaritjes së amortizimit të aktiveve të qëndrueshme dhe nuk ka asnjë shpjegim se si ka dalë gjendja e llogarisë 219, “amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara. Në aktivet qarkulluese, gjendja e llogarisë 31, “materiale” dhe 32, “objekte inventari”, paraqitet 0 lekë, ndërkohë që sipas inventarizimit të kryer, për vitin 2012, këto dy llogari paraqiten me gjendje.

- Për mos disponimin e dokumenteve të ankandit publik, të procesverbaleve të punës së komisionit të ankandit, mungesa e sigurimit të ofertës dhe kontratës origjinale, vlerësimin e gabuar të kontratës së qerasë, për dy mjete e cila **nuk e mbulon afatin e kontratës së lidhur midis palëve për** mjetet e deklaruar në pronësi, me përjashtim të një rasti, nuk ka në dosje leje qarkullimi.

Meqenëse personat e sipërpërmendur kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Tiranë, si dhe nuk ka adresim institucional për dhënien, ndjekjen e zbatimin e tyre **për masën e largimit nga detyra, të njoftohet Departamenti i Administratës Publike.**

KONTROLI I LARTË I SHTETIT